

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Lindjeve, Vdekjeve, Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve, Shkurt 2026

15.04.2026


Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat preliminare¹ në baza mujore për Lindjet, Vdekjet, Kurorëzimet dhe Shkurorëzimet për muajin shkurt 2026.

Më pak lindje në shkurt 2026 sesa në janar 2026

Në muajin shkurt 2026 janë regjistruar 2 002 lindje (brenda dhe jashtë Kosovës). Prej këtyre lindjeve të regjistruara 1 030 lindje janë meshkuj dhe 972 lindje janë femra. Në muajin shkurt 2026 kemi rënie të numrit të lindjeve rreth (13,3%) krahasuar me muajin janar 2026.

Numri i lindjeve

Janar 2026 - Shkurt 2026




¹ Shfrytëzuesve të të dhënave u rekomandohet, që këto të dhëna të merren si të dhëna preliminare dhe jo si të dhëna përfundimtare

Gjatë muajit shkurt 2026 janë regjistruar gjithsej 901 raste të vdekjeve (brenda dhe jashtë Kosovës). Nga gjithsej vdekje të regjistruara, 463 janë meshkuj dhe 438 janë femra. Krahasuar me muajin janar 2026, në muajin shkurt 2026 janë regjistruar (21,2%) raste të vdekjeve të ndodhura më pak.

Numri i vdekjeve


Janar 2026 - Shkurt 2026



Në muajin shkurt 2026 janë regjistruar gjithsej 969 kurorëzime (brenda dhe jashtë Kosovës). Krahasuar me muajin janar 2026, në muajin shkurt 2026 ka ulje të numrit të kurorëzimeve rreth (29,4%).

Numri i Kurorëzimeve


Janar 2026 - Shkurt 2026



Kurse, në këtë periudhë janë regjistruar 135 raste të shkurorëzimeve në Kosovë. Krahasuar me muajin janar 2026 ka rritje të numrit të shkurorëzimeve në muajin shkurt 2026 për (53,4%).

Numri i Shkurorëzimeve

Janar 2026 - Shkurt 2026



Këto të dhëna publikohen duke u bazuar në të dhëna administrative. Burimi i të dhënave të këtij publikimi është Agjencia e Regjistrimit Civil të Kosovës (ARC).

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Lindjeve, Vdekjeve, Kurorëzimeve dhe Shkurorëzimeve për muajin shkurt 2026, vizitoni:

<https://ask.rks-gov.net/Themes/Population>